




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primaleno Më/Dono 01-02-2022			
Nr./ organit Org. broj	Numri/Straj	Shtetëse Prllog	Vlera Vadnosë
01-110/05-113			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja d, neni 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 31.01.2022, merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 28.12.2021

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë, miraton vendimin për procesverbalin e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë, të datës 28.12.2021.

Neni 2

Pjesë e këtij vendimi është procesverbali i datës 28.12.2021.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Reshat Azizi, kryesues i mbledhjes së Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 28.12.2021 (e Martë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit, z.Reshat Azizi, Kryetari z.Sokol Haliti, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Sokol Shaqiri, Ramadan Deliu, Basri Sylejmani, Sokol Hyseni, Ekrem Ymeri, Arbnore Hajredini, Valentina Mehmeti, Ilir Zuka, Zejnepe Osmani, Ali Bajrami, Jakup Demiri, Liridona Bislimi, Sejdi Emini, Nexhat Halili, Majlinda Shabani, Remzi Salihu, Durim Sylejmani, Lindita Demelezi, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Musli Neziri, Veton Ramadani, Vilsona Maliqi-Salihu, Zyrafete Rama, Anisë Zejnullahu. Reshat Azizi, ndersa mungoj Majlinda Ostrogllava.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi i mbledhjes z.Reshat Azizi: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, Kryetarin e komunës z.Sokol Haliti, dhe juve të pranishëm. Kërkoj që ne fillim ku ju e keni marr ftesën me dy pika të rendit të ditës, por sipas kërkesës së KQZ-se do të futet edhe një pikë e rendit të ditës, dhënia e betimit të këshilltarit, z.Ali Bajrami. A jeni të pajtimit që të miratojmë rendin e ditës me këtë pikë shtesë? Kush është pro? Andaj, konsideroj që me votat e të gjithëve u miratu rendi i ditës me këto tri pika.

R e n d d i t e

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.
2. Zgjedhja e komiteteve obligative, (Komiteti për Politik dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete).
Pikë shtesë, dhënia e betimit të z.Ali Bajrami.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Dhënia e betimit të z.Ali Bajramit.

Kryesuesi i mbledhjes z.Reshat Azizi: Ftoj z.Ali Bajrami të ngritët në këmbë dhe ta bëjë betimin,

Unë, Ali Bajrami, “betohem (ose deklaroj solemnisht) se, do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e miya si anëtar i Kuvendit të Komunës së Vitisë, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës

z.Reshat Azizi, kryesues i mbledhës se kuvendit: Në fillim kërkoj që të formohet komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit. Lus subjektin LDK-në, që ta propozoj një këshillat që të jete anëtar në këtë komision.

z.Illir Zuka: Ne e propozojmë Sokol Shaqirin.

z.Reshat Azizi: A jeni të mendimit që Sokoli të jete pjese e komisionit, ju lutem me ngritje dore? Nga të gjithë u miratua ky propozim. Kërkoj nga LVV-ja që të propozon një kandidat.

z.Jakup Demiri: Ne e propozojmë Majlinda Shabanin.

z.Reshat Azizi: A jeni të mendimi që Majlinda Shabani të jete pjese e komisionit me ngritje dore. Të gjithë janë pro. Kërkoj nga PDK-ja që të propozon një këshilltar për anëtar të komisionit.

z.Musli Neziri: Ne e propozojmë Taulant Haxhiun të jet pjesë e këtij komisioni.

z.Reshat Azizi: E qes ne votim për miratim këtë propozim. Nga të gjithë u miratu dhe ky propozim. Atëherë lus anëtarët e komisioni që t’i nxan vendet e veta dhe të vazhdojmë me punën.

Sekretaria: Pasi që anëtarët e komisioni kane zënë vendet e veta, kërkojnë nga përfaqësuesit e LDK-se të bëjnë propozimin për kryetar te Kuvendit Komunal të Vitisë. znj.Arbnore Hajredini, bazuar në marrëveshjen e datës 20.12.2021 në mese të kryetarit të Komunës së Vitisë, z.Sokol Haliti dhe kryetarit te PDK-se, z. Bekim Azizi, të dy grupet janë pajtuar, që kandidat për kryesues të Kuvendit Komunal të Vitisë, të jete z.Bekim Azizi nga radhët e PDK-së. Komisioni kërkojnë ndonjë propozim nga përfaqësuesi i LVV-se.

z.Jakup Demiri: Ne nuk kemi kundërkandidat.

Komisioni: Andaj, pasi që nuk kemi kundërkandidat, fillojmë me procesin.

Sekretaria: Anëtarja e komisionit znj.Majlinda Shabani, fillon t’i ftoj këshilltaret për të votuar: Sokol Shaqiri, Ramadan Deliu, Basri Sylejmani, Sokol Hyseni, Ekrem Ymeri, Arbnore Hajredini, Valentina Mehmeti, Ilir Zuka, Zejnepe Osmani, Ali Bajrami, Jakup Demiri, Liridona Bislimi, Sejdi Emini, Nexhat Halili, Majlinda Shabani, Remzi Salihu, Durim Sylejmani, Lindita Demelezi, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Musli Neziri, Vetur Ramadani, Vilsona Maliqi-Salihu, Zyrafete Rama, Anisë Zejnullahu, Reshat Azizi. Pas përfundimit të procesit të votimit konstatojnë se pjesë e votimit kanë qen gjithsej 26 anëtar të kuvendit komunal, ndërsa ka munguar një anëtar i kuvendit. Tani kalojmë në procesin e numërimit të votave, pas numërimit të votave konstatojmë se z.Bekim Azizi ka 14 vota pro, 10 vota kundër dhe 2 vota të pavlefshme, Andaj, bazuar në nenin 41, paragrafi 41.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 të Republikës së Kosovës, konstatojmë që, kandidati z.Bekim Azizi zgjidhet kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë për mandatin e njëjtë sikurse anëtarët e kuvendit.

z.Reshat Azizi, kryesues i mbledhës së kuvendit: Të nderuar të pranishëm, kërkoj nga z.Bekim Azizi që të zë vendin këtu.

z.Bekim Azizi, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë: I nderuari kryetar, të nderuar anëtar të kuvendit, të nderuar të pranishëm, nënkryetar, ish kryesuesi i kuvendit, ju faleminderit për punën, angazhimin që ki pas për dy mandate ne kuvend. Ju falënderoj për besimin, ju falënderoj për votën e juaj, pa marr parasysh qëndrimin sepse kjo është demokraci, kjo na obligon të gjithëve së bashku që të punojmë ndershëm, bazuar në ligjet e Republikës së Kosovës. Mendoj që të gjithë së bashku do të punojmë për të mirën e qytetarëve, prandaj ju falënderoj dhe ju kërkoj bashkëpunim, që t’i ecim gjërat përpara.

Pika e tretë e rendit të ditës:

3. Zgjedhja e komiteteve obligative, (Komiteti për Politik dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete)

z.Bekim Azizi, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë: Tek Komiteti për Politik dhe Financa në bazë të vendeve që i kemi në kuvend, numri i KPF-së duhet të jetë prej 7 anëtarëve, KPF-në e kryeson kryesuesi i kuvendit, ndërsa edhe gjashtë anëtarë tjerë duhet të zgjedhën në bazë të numrit të ulëseve që i ka subjekti i LDK-së i takojnë 3 vende, subjektit të LVV-së i takojnë 2 vende dhe subjektit PDK-së i takon 1 vend edhe kryesuesi. Ne sot e miratojmë vendimin për formimin e KPF-së, ndërsa emrat e anëtarëve i sjellim në seancën e radhës, sepse ju duhet kohë për mu konsultu, atëherë e qes në votim për miratim që nga LDK-ja të jete 3 anëtarë, nga LVV-ja 2 anëtarë dhe PDK-ja 1 anëtarë dhe kryesuesin. A jeni për miratimin e këtij propozim vendimi, me 1 votë abstenim, të tjerat pro, konstatojmë që u miratu KPF-ja. Me këtë numër që e parapamë. Në Komitetin për Komunitete nga kuvendi duhet të jete dy anëtarë dhe tre anëtarë do të jenë nga përfaqësues nga komitetit serb. komiteti kroat edhe nga komitetit ashkali apo nga shoqëria civile, apo bizneset. Në Komitetit për Komunitete propozim që nga kuvendit të jete z.Reshat Azizi nga AAK-ja dhe një anëtar tjetër i kuvendit të jete nga PDK-ja. për shkak se dy grupet tjera i kanë nga dy në KPF-në. A jeni për këtë propozim? Kush është pro? Me dy vota kundër, tjerat pro, miratohet ky propozim vendim. d.m.th Komitetit për Komunitete. Në seancën e radhës do të vijnë emrat. Në KPF-ë të tri grupet duhet të dërgojnë nga një femër, sepse duhet të respektojmë kuotën gjinore.


z.Sokol Haliti, kryetar i Komunës së Vitisë: Të nderuar të pranishëm, shumë të respektuar këshilltar të kuvendit komunal dhe ju të pranishëm! Me lejoni të ju përshëndes dhe të ju uroj përzgjedhjen e kryesuesit të ri z.Azizi, i dëshiroj shëndet e suksese dhe i thamë që do t'i ofroj bashkëpunim të plotë institucional Qeveri Kuvend, ashtu siç kemi bashkëpunua edhe me krejt përbërjet e të së kaluarës. Gjithashtu me lejoni të ju uroj festat e fund vitit duke pas shëndetin.

z.Bekim Azizi, kryesuesi i Kuvendit: Kërkoj nga subjektet politike, që gjatë kohës të na njoftoni edhe me shefat e grupeve parlamentare që do t'i përfaqësoj, sepse duhet të bashkëpunojmë dhe të koordinohemi. Meqenëse është fundi i vitit, pranoni urimet me të sinqerta dhe duke ju dëshiruar shëndet e suksese, me kaq mbyllim këtë seancë. Për seancat tjera do të njoftoheni me kohe.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 10:30 min.

Procesmbajtësi:

Fatlum Demiri



Kryesuesi i Kuvendit Komunal:

Bekim Azizi

